

NR. REGJ. THEM. (1447)
Korçë, më datë 15.6.2023

SHKURTIM VENDIMI

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Sot, më datë 15.6.2023, unë gjyqtarja Eglantina Mikani, gjyqtare pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, pasi mora në rishqyrtim në dhomë këshillimi aktet e çështjes civile regjistruar me nr. 1447, e cila i përket:

Kërkues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, me adresë: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Person i tretë: Shoqëria “Mika Korçë” sh.a., me NIPT: J64103104K, me adresë: Unaza e Qytetit, Korçë.

Me objekt: Për fillimin e procedurës së falimentimit.

Baza ligjore: Nenet 9, 11, 13, 14, 17 të ligjit nr. 1 10/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”, si dhe aktin e ekspertimit datë 25.5.2023 të hartuar nga eksperti kontabël z. Luan Muça (i licencuar si auditues ligjor/administrator falimenti), bazuar në nenet 306-310 të K. Pr. Civile, nenin 29 e vijues të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”, ndër të tjera,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së palës kërkuuese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë.
2. Fillimin në datë 15.6.2023 të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Mika Korçë” sh.a., me veprimtari të saj: “grumbullimin e duhanit nga fermerët, përpunimin dhe eksportimin e duhanit; shfrytëzimin dhe rinovimin e aseteve ekzistuese, si dhe ndërtimin e aseteve të reja përpunuese të duhanit; zbatimin e teknologjive të reja për përpunimin dhe fermentimin e duhanit; dhënien e ndihmës shkencore agronomike me teknologji në fushën e kultivimit të duhanit, fermerëve privatë; etj. ...” me NIPT: J64103104K, me seli në adresën: Unaza e Qytetit, Korçë, Shqipëri.
3. Caktimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “Mika Korçë” sh.a., z. Luan Muça, i datëlindjes 18.9.1961, me nr. personal identifikimi G10918009M, mbajtës i licencës me nr. 11, datë 15.10.2012 (administrator falimentimi), me adresë: Tepelenë, lagjja “Demokracia”, tek ish-zyrat e N.T.A. dhe NIPT: K38708553S.
4. Urdhërohet publikimi/botimi i një kopjeje të shkurtuar të vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.
5. T’i kërkojë çdo personi ose subjekti që pretendon të jetë kreditor i debitorit për të paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit të falimentimit z. Luan Muça, brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
6. Të caktojë datën 28.9.2023, ora 11:00, si datë në të cilën do të mbahet mbledhja mbi raportimin e kreditorëve të shoqërisë “Mika Korçë” sh.a.
7. T’i kërkojë çdo personi fizik ose juridik, i cili ka detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Mika Korçë” sh.a. t’ia paguajë ato ndaj administratorit të falimentimit z. Luan Muça.
8. Administratori i falimentimit z. Luan Muça t’i paraqesë një kopje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit.

9. Administratori i falimentimit z. Luan Muça të paraqesë menjëherë një kopje të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit në organin e regjistrimit, i cili disponon regjistrin tregtar ku pala debitore shoqëria “Mika Korçë” sh.a. figuron e regjistruar.

10. Administratori i falimentimit z. Luan Muça t’i komunikojë vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit Zyrës Qendrore të ASHK-së, me qëllim bërjen e shënimeve përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme për çdo pasuri të paluajtshme ku debitori është regjistruar si pronar, si dhe për të gjitha të drejtat e tjera ligjore të debitorit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

11. Administratori i falimentimit z. Luan Muça të komunikojë vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit në të gjithë regjistrat e tjerë publikë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në regjistrin e barrëve sigurorese dhe regjistrat e autoriteteve të tjera publike që janë përgjegjëse për regjistrimin e pasurive ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi pasuritë që përbëjnë masën e falimentimit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Mika Korçë” sh.a. t’i njoftohet palës kërkuese, Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, si përfaqësuese e aksionarit shtet, në cilësinë e debitorit të shoqërisë “Mika Korçë” sh.a.; administratorit të falimentimit të kësaj shoqërie z. Luan Muça, si dhe vetë shoqërisë “Mika Korçë” sh.a. (për këtë të fundit nëpërmjet shpalljes publike).

13. Një kopje e vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Mika Korçë” sh.a. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Qendrës të Botimeve Zyrtare, me qëllim publikimin e shkurtimit të tij.

14. Shpenzimet gjyqësore, të cilat përbëhen nga tarifa mbi aktet, shpenzimet për ekspertin dhe shpenzimet për njoftimet, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, i ngarkohen palës kërkuese.

15. Kundër këtij vendimi pala kërkuese ka të drejtë të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar të tij.

Korçë, sot, më datë 15.6.2023.

GJYQTARE
Eglantina Mikani